



Prishtinë,

**KËRKESË PËR TRANSFERIMIN E NJË LICENCE OSE TË NJË LEJE  
PËR AKTIVITETET E VEÇANTA**

për

**1 AUTORITETI**

Në bazë të Nenit 2,7 dhe te nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-163, të shpallur më datën 27 Gusht 2010, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ka autoritetin e përgjithshëm për të aprovuar Transferimin dhe Lënien Peng te një Licence ose te një Leje për Aktivitete të Veçanta.

**2 INFORMATAT E KËRKESËS** (të plotësohen nga Departamenti Ligjor të KPMM)

Numri i Kërkesës të KPMM-së \_\_\_\_\_

Data e paraqitjes së kërkesës (dd.mm.vvv) \_\_\_\_:\_\_\_\_:\_\_\_\_

Koha e paraqitjes së kërkesës (ora ) \_\_\_\_:\_\_\_\_

Pranuar nga (Nënshkrimi) \_\_\_\_\_

**3 INFORMATAT E PARAQITËSIT TË KËRKESËS (TRANSFERUESIT)**

(të plotësohen nga paraqitësi i kërkesës)

Emri i biznesit

Përfaqësuar nga

Adresa e regjistruar zyrtarisht

Vendi i Aplikacionit

Zona Kadastrale - Komuna

Nr. Regjistrimit të biznesit

Numri i telefonit

Numri i telefonit mobil

Adresa elektronike


#### 4 INFORMATAT E PERSONIT TE I CILI BËHET TRANSFERIMI

(të plotësohen nga paraqitësi i kërkesës)

Emri i biznesit	
Përfaqësuar nga	
Adresa e regjistruar zyrtarisht	
Vendi i Aplikacionit	
Zona Kadastrale - Komuna	
Nr. Regjistrimit të biznesit	
Numri i telefonit	
Numri i telefonit mobil	
Adresa elektronike	

#### 5 PRAPAVIJA E KËRKESËS

5.1 Licenca (më tej “Licenca”) për të kërkuar \_\_\_\_\_

në \_\_\_\_\_ ishte lëshuar për  
\_\_\_\_\_ (“Transferuesi”)

më \_\_\_\_\_.

5.2 Më \_\_\_\_\_, Personi te i cili transferohet Licenca ose Leja ka regjistruar

Kompaninë \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ (“Personi te I cili transferohet Licenca ose Leja”)

dhe ka kërkuar që KPMM të bëjë transferimin e Licencës Personit te i cili bëhet Transferimi. Personi te i cili bëhet Transferimi konfirmon se një person ose një partner kualifikohet sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale 03/L-163, Neni 22 si “Person Përgjegjës”.

## **6 Dokumentacioni i kërkuar në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale Nr.03/L-163, Neni 10.2**

Nëse bartësi i Licencës për Hulumtim ose Licencës për shfrytëzim ose bartësi i një Leje dëshiron të bëjë bartjen e Licencës ose Lejes në fjalë, Bartësi i kësaj Licence ose Leje dhe pranuesi i propozuar i saj duhet që bashkërisht të dorëzojnë në KPMM një kërkesë të plotësuar në formën e paraparë së bashku me taksën e paraparë. Kësaj kërkesë duhet t'i bashkëngjiten të dhënat në vijim:

6.1. Një kopje e Licencës dhe/ose Lejes përkatëse, të marrëveshjes së propozuar për transferim si dhe të gjitha dokumentet tjera përkatëse;

6.2. Një deklaratë nga Bartësi i Licencës ose Lejes që i parashtron arsyet për transferimin e propozuar;

6.3. Të dhënat që vërtetojnë se pranuesi i transferimit sipas këtij ligji do të kishte të drejtë që të marrë Licencën ose Lejen në fjalë, nëse pranuesi i transferimit do të kishte aplikuar për atë Licencë ose Leje;

6.4. Një azhurnim të Programit të Hulumtimit, Veprimtarive të Veçanta dhe/ose Shfrytëzimit si dhe një deklaratë të lëshuar nga pranuesi i propozuar për përmbushjen e programeve të miratuara nga KPMM; dhe

6.5. Një deklaratë me shkrim nga ana e pranuesit të transferimit të propozuar që i pranon dhe do t'i përmbushë të gjitha detyrimet e mbetura të bartësit të Licencës ose Lejes – pavarësisht nëse këto detyrime lindin nga Licenca, Leja, ky ligj ose ndonjë element tjetër i Ligjit të Kosovës – nga data e hyrjes në fuqi të transferimit.

## **7 KRITERET PËR TRANSFERIM**

KPMM-ja lejon transferimin e Licencës ose Lejes pas paraqitjes së kërkesës në bazë të paragrafit 2. të këtij neni, nëse në datën e paraqitjes së kësaj kërkesë, bartësi i licencës i përmbush kushtet e përcaktuara në paragrafin 2, të këtij neni dhe kushtet e përgjithshme për dhënien e licencës ose lejes përkatëse sipas këtij ligji.

Pas miratimit të transferimit nga KPMM, pranuesi i Licencës ose Lejes është detyruar t'i përmbushë të gjitha detyrimet që dalin nga nën-paragrafi 6.5 i paragrafit 6 të këtij neni.

## **8 BARTJA E KONTROLLI**

Çdo propozim për ndryshimin e një Pronari të Rëndësishëm të një Bartësi të Licencës ose Lejes duhet të miratohet nga KPMM. KPMM mund ta refuzojë miratimin e ndryshimit nëse pronari i ri i rëndësishëm nuk i përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara në nën-paragrafin 1.2 paragrafin 1 të nenit 6 të këtij ligji ose nëse ndryshimi i propozuar do të rezultojë në humbjen e të drejtave të Bartësit të Licencës ose Lejes sipas cilës do dispozitë tjetër të nenit 6 të këtij ligji

Gjatë dorëzimit të kërkesës për miratim, sipas këtij neni 11, KPMM mund të kërkojë dorëzimin e të gjitha të dhënave të cilat KPMM me arsye i konsideron të nevojshme.

## 9 DEKLARATA E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Parashtruesi i kërkesës siguron që dokumentacioni i dorëzuar të jetë i kompletuar dhe i vërtetë. Ai gjithashtu deklaron me nënshkrimin e tij se është informuar rreth kriterëve të kualifikimit të nenit 6 të Ligjit Nr.03/L-163. Dorëzimi dhe/ose përdorimi i dokumenteve false dhe deklaratat çorientuese mund të përbënë **shkelje** në bazë të Kodit Penal të Kosovës dhe do të rezultojë **për ndjekje** penale nga autoritetet kompetente

## 10 MARRËVESHJA

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (“KPM”), në bazë të kushteve dhe kërkesave, të përcaktuara për kërkesën e parë për licencë, pajtohet që të transferojë Licencën Personit të i cili transferohet Licenca.

Licenca e transferuar i nënshtrohet kushteve dhe afateve të njëjta sikur Licenca origjinale

Transferuesi dhe Personi të i cili bëhet Transferimi janë bashkërisht dhe veçmas përgjegjës për çdo obligim ekzistues dhe në të ardhmen në bazë të Licencës dhe të Licencës së re, nëse dalin para ose pas anulimit të Licencës së vjetër dhe lëshimit të Licencës së re.

### TRANSFERUESI

NËNSHKRUAR për dhe në emër të Kompanisë: \_\_\_\_\_

përmes nënshkrimit të autorizuar Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Emri \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

### PERSONI TË I CILI BËHET TRANSFERIMI

NËNSHKRUAR për dhe në emër të Kompanisë: \_\_\_\_\_

Përmes nënshkrimit të autorizuar Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Emri \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Vërtetuar nga KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE

\_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

Ahmet Tmava,  
Kryesues i Bordit KPM